FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.58	2004	18 gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.497, datë 23.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore……	3763
Vendim i KM nr.501, datë 23.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "BOO", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA) dhe shoqërisë "Wonder" sh.a., për ndërtimin e hidrocentralit të Sasajt……	3771
Vendim i KM nr.508, datë 30.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për bashkëpunim në fushën e turizmit……	3781
Vendim i KM nr.509, datë 30.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes së përgjithshme të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Arabisë Saudite…	3783
Vendim i KM nr.511, datë 30.7.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.182, datë 25.4.1995 të Këshillit të Ministrave "Për çmimet e shitjes së barnave", të ndryshuar..	3786
Vendim i KM nr.513, datë 30.7.2004	Për klasifikimin e veprimtarisë dhe për dokumentacionin e procedurën për dhënien e lejes nga inspektori i punës, para vënies në punë të ndërmarrjes……	3787

Vendim i KM nr.515, datë 30.7.2004	Për lejimin e institucioneve buxhetore të përdorin procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" për blerje gazoili……	3788
Vendim i KM nr.520, datë 30.7.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.771, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"……	3788
Vendim i KM nr.523, datë 30.7.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.243, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore për vitin 2004 dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore"……	3789
Vendim i KM nr.524, datë 30.7.2004	Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë……	3789
Vendim i KM nr.525, datë 30.7.2004	Për procedurën e aplikimit për regjistrimin e lëndëve plasëse në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil……	3790
Vendim i KM nr.526, datë 30.7.2004	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të inspektoratit të instituteve private të pensioneve suplementare dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Këshillin e Ministrave……	3795
Vendim i KM nr.531, datë 30.7.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2004, për Ministrinë e Drejtësisë, për rritjen e kapaciteteve të burgjeve të Peqinit dhe të Rrogozhinës……	3796
Autorizim zyrtar i Komisionit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.8 datë 19.7.2004	Për të vepruar si shoqëri sigurimi	3797
Autorizim zyrtar i Komisionit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.9 datë 19.7.2004	Për të vepruar si shoqëri sigurimi.....	3797
Autorizim zyrtar i Komisionit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.10 datë 19.7.2004	Për të vepruar si shoqëri sigurimi	3797
Autorizim zyrtar i Komisionit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.11 datë 28.7.2004	Për të vepruar si shoqëri sigurimi	3798
	Ndreqje gabimi.....	3799

VENDIM
Nr.497, datë 23.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR ASISTENCË TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË MBI ASISTENCËN E NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë, këtej e tutje referuar si Palë Kontraktuese,

duke dëshiruar të kenë marrëdhënie miqësore, përfshirë dhe bashkëpunimin në çështjet doganore;

duke marrë në konsideratë që shkeljet e legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, fiskale dhe tregtare të vendeve përkatëse;

duke marrë në konsideratë rëndësinë e garantimit të një vlerësimi të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera në importimin dhe eksportimin e mallrave, si edhe përcaktimin e saktë të klasifikimit, vlerës dhe origjinës së këtyre mallrave;

duke marrë në konsideratë që trafiku i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope përbën rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

duke njohur nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në çështje që lidhen me administrimin dhe zbatimin e legjislacionit doganor;

të bindur se aksionet kundër shkeljeve doganore mund të jenë më të efektshme nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të tyre doganore;

duke marrë në konsideratë dispozitat e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi lëndët narkotike të 30 marsit 1961, Konventën mbi substancat psikotrope të 21 shkurtit 1971 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope të 19 dhjetorit 1988;

duke marrë në konsideratë dispozitat e konventave ndërkombëtare që parashikojnë ndalimet, kufizimet dhe masat specifike të kontrollit lidhur me mallra të caktuara;

duke pasur parasysh rekomandimet e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor mbi Asistencën e Ndërsjellë Administrative të 5 dhjetorit 1953,

ranë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Legjislacion doganor” do të nënkuptojë të gjitha dispozitat statutore dhe rregulluese që zbatohen ose administrohen nga autoritetet doganore dhe që kanë të bëjnë me importin, eksportin dhe transitin e mallrave, si dhe çdo procedurë tjetër, duke përfshirë dispozitat lidhur me detyrimet doganore të mbledhura nga autoritetet doganore dhe gjithashtu masat e ndalimit, kufizimit dhe të kontrollit;

b) "Autoritet Doganor” do të nënkuptojë në Republikën e Shqipërisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave dhe në Republikën e Moldavisë, Departamenti Doganor;

c) ”Autoriteti doganor kërkues” do të nënkuptojë Autoritetin Doganor që bën një kërkesë për asistencë mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje ose që merr këtë asistencë;

d)”Autoriteti doganor i kërkuar” do të nënkuptojë Autoritetin Doganor që merr një kërkesë për asistencë mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje ose që e jep këtë asistencë;

e) ”Shkelje doganore” do të nënkuptojë çdo lloj shkelje të legjislacionit doganor, si edhe çdo tentativë për shkelje të legjislacionit doganor;

f) ”Person” do të thotë si personat fizikë ashtu edhe ata juridikë, me përjashtim të rasteve kur konteksti parashikon diçka të ndryshme;

g) ”Informacion” do të nënkuptojë inter-alia, raporte, të dhëna, dokumente dhe materiale të tjera, të kompjuterizuara ose jo, si dhe kopje të noterizuara të tyre;

h) ”Dërgesë e kontrolluar” do të nënkuptojë teknikën e lejimit të ngarkesave që përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë lëndë narkotike, substanca psikotrope ose të substancave që zëvendësojnë ato, të kalojnë jashtë, përmes ose brenda territorit të shteteve të Palëve Kontraktuese, me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente, me qëllim identifikimin e personave të përfshirë në trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope.

Neni 2
Fushëmbulimi i Marrëveshjes

1. Bazuar në këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese, Autoritetet Doganore brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe duke zbatuar rregullat ligjore të Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mënyrë që:

a) të përmirësojnë trafikun e pasagjerëve dhe mallrave ndërmjet shteteve të Palëve Kontraktuese;

b) të sigurojnë mbledhjen e duhur të detyrimeve doganore dhe të detyrimeve të tjera të importit dhe të eksportit, si dhe krijimin e lehtësirave doganore;

c) të parandalojnë, të hetojnë dhe të ndëshkojnë shkeljet doganore.

2. E gjithë asistenca në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet në përputhje me ligjet kombëtare të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje kanë të vetmin qëllim për të siguruar asistencë të ndërsjellë ndërmjet Autoriteteve Doganore të Palëve Kontraktuese.

4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk i japin të drejtë asnjë pale ose personi për të penguar ekzekutimin e një kërkese.

Neni 3
Thjeshtëzimi i procedurave doganore

Autoritetet Doganore:

a) Adoptojnë me marrëveshje dypalëshe masat e nevojshme për të thjeshtëzuar procedurat doganore, me qëllim përshpejtimin e lëvizjes së pasagjerëve dhe trafikut të mallrave ndërmjet shteteve të Palëve Kontraktuese.

b) Njohin garanci të përbashkëta doganore (ndalime, vula, plumbçe etj.) dokumente doganore dhe në rast nevoje, zbatojnë masat e tyre të sigurisë për mallrat e transportuara.

Neni 4
Fushëmbulimi i asistencës

1.Asistenca e dhënë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të përfshijë inter-alia, me iniciativën e autoriteteve doganore ose sipas kërkesës, dhënien e informacionit të prirur për të siguruar zbatimin e legjislacionit doganor, si dhe garantimin e një vlerësimi të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera në importimin dhe eksportimin e mallrave, si edhe përcaktimin e saktë të klasifikimit, vlerës dhe origjinës së këtyre mallrave nga Autoritetet Doganore. Ky informacion do të përmbajë gjithashtu, por nuk do të kufizohet me:

a) Veprime për zbatimin e ligjit që mund të jenë të dobishme për parandalimin e shkeljeve doganore dhe në veçanti mënyra speciale për të luftuar shkeljet doganore;

b) Metoda të reja të përdorura për kryerjen e shkeljeve doganore;

c) Observime dhe gjetje të cilat kanë ardhur si rezultat i zbatimit të suksesshëm të teknikave të reja dhe metodave të antikontrabandës;

d) Teknika dhe metoda të përmirësuara të përpunimit të pasagjerëve dhe mallrave.

2. Asistenca e dhënë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të ofrohet për përdorim në të gjitha procedimet në shtetin e Palës Kontraktuese kërkuese, si ato juridike, administrative apo të hetimit dhe do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në procedimet për klasifikimin, vlerën, origjinën, si dhe karakteristika të tjera që lidhen me zbatimin e legjislacionit doganor.

3. Palët Kontraktuese, përmes autoriteteve të tyre doganore, nëse nuk është në kundërshtim me ligjet e tyre kombëtare, do të kërkojnë gjithashtu bashkëpunim në:

a) Nxitjen, zhvillimin dhe përmirësimin e programeve specifike të trajnimit për personelin e tyre;

b) Vendosjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit për të lehtësuar shkëmbimin e shpejtë dhe të sigurt të informacionit;

c) Nxitjen e koordinimit efikas, përfshirë shkëmbimin e personelit, specialistëve dhe dërgimin e zyrtarëve ndërlidhës;

d) Marrjen në konsideratë dhe testimin e pajisjeve ose procedurave të reja;

e) Thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave të tyre doganore dhe

f) Çdo çështje tjetër administrative të përgjithshme.

4. Asistenca në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje nuk do të përfshijë arrestimet e personave, gjithashtu edhe mbledhjen me forcë të detyrimeve doganore, taksave të tjera, gjobave dhe të ardhurave të tjera.

Neni 5
Komunikimi i informacionit

Autoritetet Doganore në periudhën më të shkurtër të mundur i komunikojnë njëra-tjetrës, edhe pa kërkesë, me iniciativën e tyre, çdo informacion të një natyre të konsiderueshme, i cili është zbuluar gjatë kryerjes së aktiviteteve normale dhe që jep arsye të forta për të besuar se me shkelje serioze doganore do të kryhet në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese. Informacioni që do të komunikohet do të përmbajë, në veçanti, lëvizjen e:

a) Mallrave, të cilat mund të paraqesin rrezik për ambientin ose për shëndetin njerëzor;

b) Armatimeve, municioneve, lëndëve eksplozive ose helmuese, pajisjeve eksplozive;

c) Objekteve që kanë vlera historike, artistike, kulturore ose arkeologjike;

d) Mallrave të një rëndësie të lartë, të cilat u nënshtrohen kufizimeve jotarifore, në përputhje me katalogët e koordinuar me Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese.

Neni 6

Kërkesa të veçanta të asistencës

1. Sipas kërkesës, Autoritetet Doganore do të informojnë njëra-tjetrën nëse mallrat e eksportuara nga, ose të importuara për në territorin e shtetit të njërës prej Palëve Kontraktuese janë importuar për në, ose eksportuar nga territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese në mënyrë të ligjshme. Informacioni do të përmbajë, sipas kërkesës, procedurën doganore të përdorur për zhdoganimin e mallrave. Kjo aplikohet edhe për rastet kur mallrat janë rieksportuar nga territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Autoritetet Doganore të njërës Palë Kontraktuese, me iniciativën e tyre, e cila më vonë do të miratohet me shkrim nga Autoritetet Doganore të Palës tjetër Kontraktuese, ose me kërkesë të këtyre autoriteteve doganore, do të kryejnë, në kufijtë e kompetencave të tyre, mbikëqyrje të veçantë kundrejt:

a) Mjeteve të transportit, të cilat dyshohet se janë përdorur për shkelje doganore brenda territorit të shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese;

b) Mallrave të përcaktuara nga Pala Kontraktuese kërkuese si objekt i një tregtie të gjerë klandestine që kanë si destinacion vendin e Palës Kontraktuese kërkuese;

c) Personave të veçantë të cilët dihet ose dyshohet se janë përfshirë në një shkelje doganore.

3. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të sigurojnë për njëra-tjetrën të gjitha informacionet në dispozicion që kanë të bëjnë me aktivitete të cilat mund të rezultojnë në shkelje doganore në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese. Në rastet kur ekziston rreziku i një dëmi të konsiderueshëm për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike ose i çdo interesi tjetër jetësor për secilën nga Palët Kontraktuese, ky informacion do të jepet pa qenë e nevojshme të kërkohet.

4. Për qëllimet e parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore që kanë të bëjnë me lëndët narkotike dhe substancat psikotrope, Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës sa më shpejt të jetë e mundur, pa qenë nevoja për një kërkesë, të gjitha informacionet që lidhen me shkeljet e mundshme të legjislacionit doganor të Palës tjetër Kontraktuese.

5. Autoritetet Doganore, sipas kërkesës, do të sigurojnë për njëra-tjetrën të gjitha informacionet lidhur me faktin se faturat dhe dokumente të tjera, të paraqitura te strukturat doganore nën urdhrat e tyre, janë origjinale dhe përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm.

Neni 7

Lufta kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope

1. Me qëllim intensifikimin e veprimeve në lidhje me parandalimin, hetimin dhe luftën kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave të tjera që i zëvendësojnë ato, Autoritetet Doganore do të sigurojnë për njëra-tjetrën, pa ndonjë kërkesë paraprake dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, gjithë informacionin lidhur me:

a) personat që njihen ose dyshohen si trafikantë të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave që i zëvendësojnë ato;

b) mjetet e transportit, përfshirë kontenierët dhe dërgesat postare, të cilat dihet ose dyshohet se janë përdorur për trafik të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave që i zëvendësojnë ato.

2. Autoritetet Doganore, pa ndonjë kërkesë paraprake, informojnë njëra-tjetrën për metodat e përdorura në trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave që i zëvendësojnë ato, si dhe për mënyrat e reja të kontrollit të tyre.

3. Informacionet, mesazhet dhe dokumentet e marra nga Palët Kontraktuese, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, mund t'u transmetohen strukturave qeveritare që merren me luftën kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave që i zëvendësojnë ato.

Neni 8
Dërgesë e kontrolluar

1. Palët Kontraktuese do të marrin masat e nevojshme, brenda mundësive të tyre, për të lejuar përdorimin e duhur të dërgesave të kontrolluara në nivel ndërkombëtar me qëllim identifikimin e personave të përfshirë në trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope dhe ndërmarrjes së veprimeve ligjore kundrejt tyre.

2. Vendimi për të përdorur dërgesën e kontrolluar do të merret rast pas rasti dhe, kur të jetë e nevojshme, në përputhje me rregullimet dhe marrëveshjet të cilat mund të jenë arritur lidhur me një rast të veçantë. Ata, nëse është e nevojshme dhe nëse përputhet me legjislacionin kombëtar, mund të marrin parasysh marrëveshjet financiare dhe mirëkuptimet e arritura.

3. Ngarkesat e paligjshme për dërgesën e kontrolluar të të cilave është rënë dakord, me pëlqimin e përbashkët të autoriteteve kompetente, mund të identifikohen dhe të lejohen të vazhdojnë me lëndët narkotike ose substancat psikotrope të paprekura, të hequra ose të zëvendësuara pjesërisht ose tërësisht.

Neni 9
Dokumentet dhe dërgimi i tyre

1. Autoritetet Doganore të njërës Palë Kontraktuese do të dërgojnë, me kërkesë të Autoriteteve Doganore të Palës tjetër Kontraktuese, dokumente Palës Kontraktuese kërkuese. Kjo dërgesë do të evidentohet nga një faturë e marrësit ku të tregohet data e dërgimit ose nga një certifikatë ku të përshkruhet mënyra dhe data e dërgimit.

2. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, gjatë 3 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shkëmbejnë kopje të legjislacionit doganor dhe akteve në fuqi dhe duhet të informojnë menjëherë për të gjitha ndryshimet ose shtesat që mund t'i bëhen legjislacionit të tyre doganor.

3. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të sigurojnë, sipas kërkesës, dokumente lidhur me transportimin dhe dërgimin e mallrave, duke treguar vlerën, procedurën dhe destinacionin e këtyre mallrave.

4. Me anë të një kërkese të veçantë kopjet e dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera do të noterizohen. Origjinalet e këtyre dosjeve, dokumenteve ose materialeve të tjera do të kërkohen vetëm në rastet kur paraqitja e kopjeve nuk do të ishte e mjaftueshme.

5. Dhënia e dosjeve origjinale, dokumenteve ose materialeve të tjera në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë të drejtat e administratës doganore të kërkuar dhe as ato të palëve të treta. Këta origjinalë do të kthehen sa më shpejt të jetë e mundur.

6. Informacionet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje mund të ofrohen në formë të kompjuterizuar. Në raste të tilla, bashkë me to do të dërgohet çdo udhëzim ose informacion i nevojshëm për interpretimin dhe përdorimin e këtij informacioni.

7. Me kërkesë të Autoritetit Doganor të njërës Palë Kontraktuese, Autoritetet Doganore të Palës tjetër Kontraktuese sipas pëlqimit të tij, do të autorizojnë zyrtarët e vet, në rast se këta zyrtarë e pranojnë këtë, të paraqiten si dëshmitarë në proceset ligjore ose administrative në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, si dhe të paraqesin dosjet, dokumentet dhe materiale të tjera ose kopje të njehsuara me origjinalin, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për procedimet.

8. Me kërkesë të Autoritetit Doganor të njërës Palë Kontraktuese, Autoritetet Doganore të Palës tjetër Kontraktuese do të dorëzojnë kopje të vendimeve të strukturave administrative në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor.

9. Marrja e dokumenteve duhet të autorizohet nga autoriteti doganor i kërkuar, duke treguar datën e marrjes së tyre.

10. Një kërkesë e tillë do të përfshijë datën dhe llojin e procedimit, emrat e palëve të përfshira, si dhe kompetencat me të cilat duhet të paraqitet zyrtari.

Neni 10

Shkëmbimi i eksperiencës dhe i asistencës

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese shkëmbejnë informacion mbi:

a) eksperiencën e tyre për aktivitetet doganore, si dhe për metodat e reja të kryerjes së shkeljeve doganore;

b) pajisjet teknike ndihmëse të përdorura nga Autoritetet Doganore;

c) probleme të tjera doganore, për të cilat të dyja Palët Kontraktuese janë të interesuara.

2. Autoritetet Doganore i japin njëra-tjetrës asistencë të ndërsjellë për çështjet doganore përfshirë dhe:

a) shkëmbimin e zyrtarëve doganorë për të marrë njohuri për pajisjet e përdorura prej tyre;

b) trajnimin dhe asistencën për punonjësit doganorë;

c) shkëmbimin e specialistëve në çështjet doganore;

d) shkëmbimin e informacioneve teknike, profesionale dhe shkencore në lidhje me çështjet doganore.

Neni 11

Kontrolli dhe ekzaminimi

1. Me kërkesë të Autoriteteve Doganore të njërës Palë Kontraktuese, Autoritetet Doganore të Palës tjetër Kontraktuese organizojnë kontrollin ose ekzaminimin e rasteve të parashikuara në nenin 2 paragrafi 1 (b) dhe (c) të kësaj Marrëveshjeje. Rezultatet e kontrollit ose të ekzaminimit do t'i komunikohen autoritetit doganor kërkues.

2. Kontrolli dhe ekzaminimi do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Autoriteti doganor i kërkuar mund të lejojë persona zyrtarë të autoritetit doganor kërkues të marrin pjesë gjatë kontrollit ose ekzaminimit.

Neni 12

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për asistencë

1. Kërkesat që do të paraqiten në kuadrin e Marrëveshjes do të bëhen me shkrim. Dokumente të nevojshme për ekzekutimin e kësaj kërkese do të shoqërojnë kërkesën. Kur të kërkohet, për shkak të situatave urgjente kërkesat e bëra gojarisht do të pranohen, por do të konfirmohen menjëherë me shkrim.

2. Kërkesat sipas paragrafit 1 të këtij neni do të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) autoritetin që bën kërkesën;

b) natyrën e procedimit;

c) objektin dhe arsyet për të cilat bëhet kërkesa;

d) emrat dhe adresat e palëve të përfshira në kërkesë, nëse dihen;

e) një përshkrim të shkurtër të problemit për të cilin bëhet kërkesa dhe elementet ligjore që janë përfshirë në të;

f) lidhjen midis asistencën së kërkuar dhe problemeve me të cilat lidhet.

3. Kërkesat do të paraqiten në gjuhën zyrtare të Palës Kontraktuese të kërkuar, në anglisht ose në gjuhë të tjera të pranueshme nga të dyja Palët Kontraktuese.

4. Asistenca do të kryhet nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet Autoriteteve Doganore përkatëse.

5. Në rast se autoriteti doganor i kërkuar nuk është struktura e duhur për të përmbushur kërkesën, ai, pas konsultimeve të duhura, ose do t'ia transmetojë menjëherë kërkesën strukturës së duhur, e cila do të veprojë me kërkesën në përputhje me kompetencat e saj sipas ligjit, ose do të këshillojë autoritetin doganor kërkues për procedurën e duhur që duhet të ndjekë në lidhje me këtë kërkesë.

Neni 13
Përjashtimet nga dhënia e asistencës

1. Në rastet kur Pala Kontraktuese e kërkuar është e mendimit se përmbushja e kërkesës do të shkelte sovranitetin, sigurinë, politikat publike të tij ose interesa të tjera thelbësore kombëtare, asistenca mund të refuzohet ose mund të jepet e kushtëzuar nga përmbushja e disa kushteve ose kërkesave të caktuara.

2. Në rast se asistenca nuk mund të përmbushet, administrata doganore kërkuese do të njoftohet menjëherë për këtë fakt, si dhe do t'i paraqiten arsyet.

3. Kur autoriteti doganor kërkues kërkon asistencë, të cilën ai vetë nuk do të ishte në gjendje ta ofronte në rast se do t'i kërkohej, ai do ta paraqesë këtë fakt në kërkesë. Do të jetë autoriteti doganor i kërkuar ai që do të vendosë se si do t'i përgjigjet kësaj kërkese.

4. Asistenca mund të shtyhet nga autoriteti doganor i kërkuar për arsye se mund të ndërhyjë në hetimet, ndjekjet penale ose procedimet që janë duke u kryer. Në raste të tilla, ajo do të konsultohet me autoritetin doganor kërkues për të përcaktuar nëse asistenca mund të jepet në bazë të kushteve dhe termave që do të kërkojë autoriteti doganor kërkues.

Neni 14
Konfidencialiteti

1. Informacionet, si dhe komunikimet e tjera të marra gjatë asistencës së ndërsjellë mund të përdoren vetëm për qëllimet e specifikuara në këtë Marrëveshje, përfshirë përdorimin në procedimet ligjore ose administrative.

2. Çdo informacion ose komunikime të tjera të marra nga Autoritetet Doganore të secilës Palë Kontraktuese, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, do të trajtohen si konfidenciale dhe nuk do t'i komunikohen asnjë personi ose strukture, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

3. Këto informacione dhe komunikime do të gëzojnë çdo lloj mbrojtjeje, në lidhje me konfidencialitetin dhe sekretin e tyre, që parashikohet në shtetin e Palës Kontraktuese, Autoriteti Doganor i së cilës i ka marrë ato.

4. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të gjejnë zbatim për rastet që kanë të bëjnë me shkeljet lidhur me lëndët narkotike dhe substancat psikotrope. Ky informacion mund t'u komunikohet autoriteteve të tjera të Palës Kontraktuese kërkuese, të përfshira drejtpërdrejt në luftën kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope.

5. Autoriteti doganor kërkues nuk do t'i përdorë provat ose informacionet e marra në kuadër të kësaj Marrëveshjeje për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në kërkesë pa miratimin paraprak të autoritetit doganor të kërkuar.

Neni 15
Ekzekutimi i kërkesës

1. Autoriteti doganor i kërkuar do të marrë të gjitha masat për të ekzekutuar kërkesën dhe, nëse është e nevojshme, do të përpiqet të marrë çdo masë zyrtare ose ligjore të nevojshme për kryerjen e kërkesës.

2. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk e disponon informacionin e kërkuar, ai do të përpiqet ta marrë atë informacion si të ishte duke vepruar për llogari të tij ose për llogari të autoritetit doganor kërkues.

3. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të kryejnë, me kërkesë të Autoritetit Doganor të njërës prej Palëve Kontraktuese, çdo hetim të nevojshëm, përfshirë marrjen në pyetje të specialistëve, dëshmitarëve ose personave të dyshuar se kanë kryer shkelje doganore, si dhe do të kryejnë verifikime, inspektime dhe hetime për mbledhjen e fakteve në lidhje me çështjet të cilave iu referohet kjo Marrëveshje.

4. Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar mund të lejojë, në maksimumin e mundshëm, zyrtarët e autoritetit doganor kërkues të jenë të pranishëm në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar, kur zyrtarët e kësaj të fundit hetojnë shkelje doganore, të cilat përbëjnë shqetësim për autoritetin doganor kërkues.

5. Autoriteti doganor kërkues do të këshillohet, nëse kërkohet, për orën dhe vendin e veprimeve që do të ndërmerren në përgjigje të kërkesës, në mënyrë që veprimet të koordinohen.

6. Zyrtarët e autoritetit doganor kërkues, të autorizuar për të hetuar shkeljet doganore, mund të kërkojnë që autoriteti doganor i kërkuar të kontrollojë çdo informacion të nevojshëm, përfshirë libra, regjistra dhe dokumente të tjera ose të dhëna mediatike dhe të paraqesë kopjet e tyre, ose të japë informacion lidhur me ato shkelje doganore.

Neni 16
Përdorimi i informacionit të marrë

1. Autoritetet Doganore mund të përdorin, si provë, informacionin dhe dokumentet e marra në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, në procesverbalet e procedimeve, në komunikimet e tyre dhe në depozitimet e dëshmitarëve në rastet e hetimeve, debateve administrative dhe ligjore që lidhen me çështjet doganore.

2. Cilësimi i këtyre dokumenteve dhe informacioneve, si dhe mënyra e përdorimit të tyre gjatë debateve ligjore ose administrative përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 17
Shpenzimet

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese normalisht do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e shpenzimeve si pasojë e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve për dëshmitarët, dietave të specialistëve, si dhe për shpenzimet e përkthyesve të cilët nuk janë nëpunës qeveritarë.

2. Në rast se ka ose kërkohen shpenzime të një natyre të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme në mënyrë që kërkesa të ekzekutohet, Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe për mënyrën me të cilën do të përballohen shpenzimet.

Neni 18
Zbatimi i Marrëveshjes

Autoritetet Doganore do të jenë përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato, inter-alia:

a) do të komunikojnë drejtpërdrejt për qëllime që lidhen me çështje që dalin si rezultat i kësaj Marrëveshjeje;

b) pas konsultimeve, nëse është e nevojshme, do të nxjerrin direktiva administrative ose bien dakord për procedurat mbi vënien në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;

c) do të përpiqen përmes një marrëveshjeje të përbashkët për të zgjidhur çdo problem ose dyshim që lind nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ose çdo çështje tjetër doganore e cila mund të lindë ndërmjet tyre;

d) do të vendosin kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet shërbimeve të tyre të informacionit.

Neni 19
Zbatueshmëria territoriale

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territoret doganore të shteteve të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 20
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën përmes shkëmbimit të notave diplomatike kur të jenë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pasi të jetë marrë njoftimi i fundit.

2. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese bien dakord të takohen me synim rishikimin e kësaj Marrëveshjeje ose për të diskutuar mbi çdo çështje tjetër doganore që mund të lindë nga marrëdhënia midis tyre, me kërkesë të njërit Autoritet Doganor ose në fund të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, me përjashtim të rastit kur ato njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë nuk është i nevojshëm.

3. Kjo Marrëveshje është parashikuar të jetë e një kohëzgjatjeje të pakufizuar.

4. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga secila prej Palëve Kontraktuese:

a) me marrjen nga njëra Palë Kontraktuese të një njoftimi me shkrim përmes kanaleve diplomatike;

b) në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë së qeni në fuqi gjashtë muaj pasi të jetë marrë ky njoftim.

Në dëshmi të kësaj nënshkruesit, të autorizuar përkatësisht nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Chisinau, më datë 11 qershor në dy kopje origjinale, në shqip, moldavisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në anglisht do të merret për bazë.

VENDIM
Nr.501, datë 23.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS "BOO", NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRISË DHE TË ENERGJETIKËS, MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT, SI ORGAN SHTETËROR I AUTORIZUAR (OSHA), DHE SHOQËRISË "WONDER" SH.A. PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SASAJT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "BOO", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA), dhe shoqërisë "Wonder" sh.a., Tiranë, për ndërtimin e hidrocentralit të Sasajt, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

KONCESIONI E FORMËS "BOO" (NDËRTIM, PRONËSI, SHFRYTËZIM PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SASAJT)

Ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit, përcaktuar si "Organ Shtetëror i Autorizuar" (OSHA), nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.634, datë 18.9.2003, që më poshtë do të quhet i tillë, dhe shoqërisë "Wonder" sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr.25389, datë 9.3.2001 të Gykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet "Koncesionari".

HYRJE

Duke pasur parasysh që Qeveria shqiptare:

- Autorizon sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.634, datë 18.9.2003 "Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës "BOO" të hidrocentralit të Sasajt", Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, të negociojnë dhe të nënshkruajnë Marrëveshjen e koncesionit;
- Konsideron privatizimin e sektorit elektroenergjetik si një element të rëndësishëm të politikës elektroenergjetike;
- Vlerëson formën "BOO" të koncesionit, që bën të mundur ndërtimin e hidrocentraleve vendore pa prekur Buxhetin e Shtetit;
- Është e angazhuar për ngritjen dhe për zhvillimin e tregut të enegjisë elektrike brenda vendit;
- Mirëpret investitorët vendas në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

Koncesionari:

- Është seriozisht i interesuar të investojë në fushën e elektroenergjetikës;
- Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara, si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare, që vërtetohen me dokumentet e paraqitura nga ai;
- Ka kryer studimin tekniko-ekonomik për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit të Sasajt, objekt i këtij koncesioni;
- Ka përgatitur projektidenë, në muajin mars 2003, bazuar në detyrën e projektimit të dërguar nga ana e tij, Institutit të Studimeve e Projektimeve Hidroteknike Tiranë, për studimin dhe projektimin e H/C Sasaj;
- Ka paraqitur pranë Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, me shkresën nr.41 Prot., datë 11.4.2003, kërkesën për një propozim të pakërkuar të formës "BOO" për ndërtimin e hidrocentralit të Sasajt;
- Ka marrë nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, me shkresën nr.2717 Prot., datë 5.5.2003 kërkesat për plotësim të dokumentacionit dhe për kryerjen e oponencës nga Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë;
- Ka dërguar në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, me shkresën nr.47 Prot., datë 28.5.2003, dokumentacionin plotësues dhe oponencën;
- Ka marrë nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, me shkresën nr.2717/2 Prot., datë 2.6.2003 kërkesën për sqarime të oponencës të kryer nga Akademia e Shkencave, për H/C Sasaj;
- Ka dërguar në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, me shkresën nr.51 Prot., datë 23.6.2003 plotësimin e oponencës të kërkuar nga ajo;
- Ka marrë nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, me shkresën nr.4148/8 prot., datë 1.10.2003 vendimin e Këshillit të Ministrave nr.634, datë 18.9.2003 "Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion të formës "BOO" të hidrocentralit të Sasajt".

Palët

Bien dakord që të bashkëpunojnë për ndërtimin e hidrocentralit Sasaj, me koncesion të formës "BOO", që më poshtë do të quhet "Hidrocentrali";

Neni 1
Përkufizime

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ata do të kenë kuptimet përkatëse të shënuara si vijon:

- Marrëveshja e koncesionit: Kjo Marrëveshje dhe aneksi nr.1;
- Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
- Koncesionari: Shoqëria "Wonder" sh.a., rruga "Ismail Qemali", Qendra e Biznesit kati i III-të, pallati përballë INIMA-s, Tiranë, me president Z.Vasil Gjika;
- Hidrocentrali: Hidrocentrali Sasaj, në rrethin e Sarandës me nënobjektet;
- Kontratat: Të gjitha kontratat e lidhura nga Koncesionari për realizimin e projektit;
- Lejet: Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet që Koncesionari mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e plotë të projektit, si dhe për stafin e vet, në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- Fillimi i punimeve: Periudha njëzetmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje koncesioni;
- ERE: Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike;
- KESH sh.a.: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare;
- KK UJËRAVE: Këshilli Kombëtar i Ujërave.

Neni 2
Objekti i koncesionit

Objekti i koncesionit është:

- E drejta që Organi Shtetëror i Autorizuar i ka dhënë Koncesionarit, në bazë të termave dhe kushteve të parashtuara në nenet e kësaj Marrëveshjeje, për ndërtimin, pronësinë dhe shfrytëzimin e hidrocentralit Sasaj në rrethin e Sarandës, për prodhimin e energjisë elektrike, sipas projektidesë së paraqitur nga Koncesionari, pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës;
- E drejta që Organi Shtetëror i Autorizuar i ka dhënë Koncesionarit për përdorimin e kanalit ekzistues nga burimi deri te tuneli me gjatësi rreth 1,2 km, tunelit me gjatësi rreth 2,35 km dhe kanalit ekzistues 3,53 km mbas tunelit, për vendin e parashikuar në projekt për basenin me presion me kapacitetet 12 000 m^3, për vendin e parashikuar në projekt për tubacionin e turbinës me gjatësi 810 ml, për vendin e parashikuar në projekt për kapërderdhësin anësor, ndërtesën e centralit, nënstacionin 35 kV, kanalin me gjatësi 60 ml, pra veprën hidroenergjetike të kompletuar.

Neni 3
Karakteristikat e hidrocentralit Sasaj

Karakteristikat kryesore janë:

Prurja	Qllog=Qhc=3,2 m^3/sek
Kuota e nivelit të ujit në anën e sipërme	219,55-222,05 metër absolut
Kuota e nivelit të ujit në anën e poshtme	4,25-5,10 metër absolut
Prurja normale e turbinës	1,2-2m^3/sek
Tipi i turbinës	Frensis, me aks horizontal
Diametri i rrotës së punës	950 mm
Numri i rrotullimeve të turbinës	1000 rrotullime/min
Fuqia e H/C-it	N= 5.500 kW
Prodhimi mesatar vjetor i energjisë	E= 23 milion kWh

Vëllimet kryesore të punimeve:

1. Gërmime dheu	64 000 m^3
2. Betone dhe betonarme	8 500 m^3
3. Hekur betoni	160 ton
4. Tubacion metalik	300 ton

Neni 4
Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e Marrëveshjes konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari angazhohet që:

- Të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për projektin që do të zbatojë;
- Të projektojë dhe të ndërtojë këtë hidrocentral konform standardeve të përparuara bashkëkohore;
- Të ndërtojë hidrocentralin Sasaj, duke siguruar vetëfinancimin e tij, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje;
- Të formojë shoqërinë koncesionare brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së koncesionit;
- Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive koncesionare;
- Të marrë masa me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë Marrëveshje dhe me cilësinë e kërkuar;
- Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'u shkaktohet palëve të treta;
- Të mbajë të informuar OSHA-në për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha dispozitat ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për marrëdhëniet e punës;
- Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;
- Të realizojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm;
- Të zgjidhë problemin e përdorimit të ujit pranë Këshillit Kombëtar të Ujërave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit dhe përdorimit të tyre nga shoqëria koncesionare;
- Të përjashtojë çdo lloj përgjegjësie të OSHA-së, përsa parashikohet në këtë nen, për dëmet, dëmtimet dhe të tjera që mund t'i ndodhin Koncesionarit dhe punonjësve të tij gjatë periudhës së koncesionit.

Neni 5
Detyrimet e OSHA

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- Të ndihmojë Koncesionarin për aplikimet, marrëveshjet ose kontratat e nevojshme për zbatimin e projektit me institucionet e tjera si ERE, KK i Ujërave, KESH etj.;

- Të ndihmojë Koncesionarin në finalizimin e një marrëveshjeje afatgjatë me KESH sh.a., për shitjen e energjisë elektrike, për aq kohë sa KESH sh.a., të jetë me kapital tërësisht shtetëror;

- Të ndihmojë Koncesionarin pranë KESH-it ose pranë institucioneve kompetente, për marrjen e lejes së nevojshme, për lidhjen me sistemin elektroenergjetik dhe transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrali Sasaj;

- Të asistojë pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme, me qëllim që Koncesionari të ushtrojë veprimtarinë koncesionare;

- T'i vërë në dispozicion Koncesionarit zonën e koncesionit brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes;

- Të mos nënshkruajë marrëveshje me asnjë person fizik ose juridik vendas apo të huaj, që në ndonjë mënyrë mund të sjellin direkt apo indirekt, efekte që mund të zvogëlojnë prurjet e burimeve të Tatzatit, si dhe prurjet e ujit përgjatë veprave të përcaktuara në objektin e kësaj Marrëveshjeje, deri në ndërtesën e hidrocentralit.

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme deri tani, investimet e nevojshme për objektin e kësaj kontrate janë vlerësuar rreth 9.45 milionë USD, bazuar në studimin e prifizibilitetit, që përmban relacionin teknik dhe planimetritë bashkëlidhur.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;

- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Koncesionari do t'ia paraqesë OSHA-së situacionet e punimeve me kërkesën e saj.

Neni 7

Shitja e energjisë elektrike të prodhuar

Shitja e energjisë elektrike të prodhuar do të bëhet sipas çmimit të aprovuar nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE). Autorizohet shoqëria shpërndarëse elektrike, me kapital tërësisht shtetëror, të lidhë me Koncesionarin një marrëveshje afatgjatë, për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar, për një periudhë kohore për të cilën palët do të bien dakord.

Neni 8

Furnizimi me ujë

Në zbatim të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", Koncesionari do të aplikojë pranë Këshillit Kombëtar të Ujit për lejen e përdorimit të ujit.

Në këtë kuadër Koncesionari merr përsipër të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit dhe përdorimit të tyre. Organi Shtetëror i Autorizuar, në rast nevoje, asiston në zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkëveprimit dhe të përdorimit të ujit, në interes të përdoruesve të ujit për ujitje dhe të Koncesionarit.

Neni 9

Vënia në dispozicion e vendit të ndërtimit sipas projektit të paraqitur

Koncesionari, mbi bazën e nevojave të projektit do t'i propozojë OSHA-së zona, të cilat do të shpronësohen.

Zonat private do të shpronësohen sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen e përdorimit të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik". Efektet financiare të shpronësimeve përballohen nga Koncesionari.

Neni 10
Servitutet e zonës

Në rastin e ekzistencës së kanalizimeve të mundshme nëntokësore (ujë, gaz etj.) (përjashto linjat elektrike) që mund të ndërhyjnë në zonat e interesuara, OSHA-ja në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, do të marrë masa për të gjetur zgjidhje sipas së drejtës civile shqiptare, që të lejojnë Koncesionarin të realizojë dhe të administrojë hidrocentralin pa asnjë kufizim operativ.

Neni 11
Programi i punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin e mëposhtëm:

1. Koncesionari merr përsipër të përfundojë projektzbatimin brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

2. Koncesionari merr përsipër të fillojë punën brenda 20 (njëzet) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Koncesionari merr përsipër të përfundojë këtë hidrocentral brenda 40 (dyzet) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

4. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis dy palëve.

Neni 12
Periudha e koncesionit

Në përputhje me këtë Marrëveshje koncesioni, OSHA-ja i jep Koncesionarit të drejtën e ndërtimit të hidrocentralit Sasaj.

Përfundimi i punimeve dhe i vënies në punë të hidrocentralit shprehet nëpërmjet paraqitjes së një raporti të hollësishëm të përgatitur dhe të miratuar nga të dyja palët.

Periudha koncesionare do të jetë 30 (tridhjetë) vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje koncesionare.

Neni 13
Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) ka të drejtë të kërkojë prishjen e Marrëveshjes së koncesionit në mënyrë të njëanshme, për rastet kur konstaton shkelje të vazhdueshme dhe të rënda të detyrimeve të marrësit të koncesionit në këtë Marrëveshje, të cilat kompromentojnë grafikun e investimit, cilësinë e punimeve dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Kur nga ana e OSHA-së provohet se gjatë periudhës së koncesionit, ka shkelje të ndonjë prej pikave të përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, ai menjëherë ia bën të njohur këto shkelje Koncesionarit dhe është i detyruar të presë për një periudhë 60-ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse.

Mbi bazën e përgjigjeve arsyetohen për të filluar ose jo procedurat për prishjen e Marrëveshjes.

Neni 14
Kontratat

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes ose nënkontraktorët, Koncesionari angazhohet të respektojë klauzolat dhe normat e fiksuara në këtë Marrëveshje koncesioni.

Pavarësisht nga kontratat e mësipërme, përgjegjës para OSHA-së për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen OSHA-së në këtë kontratë, OSHA-ja nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve.

Neni 15
Sigurimet

Koncesionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari do t'i japë OSHA-së, me kërkesën e saj, dokumentet për të gjitha llojet e sigurimeve.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari do të përdoren për të rindërtuar, për të riparuar, për të risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale.

Neni 16
Zonat e sigurisë

OSHA-ja dorëzon te Koncesionari, bashkë me zonat e tjera të përcaktuara në objektin e kësaj Marrëveshjeje, edhe zonën e sigurisë së tyre, në përputhje me nenin 61 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 17
Provat dhe vënia në punë

Provat për vënien në punë të hidrocentralit do të bëhen nga Koncesionari dhe në përfundim të tyre hartohet akti për përfundimin me sukses të provave. Që nga ky moment hidrocentrali konsiderohet i gatshëm për shfrytëzim.

Në kryerjen e provave mund të asistojnë dhe përfaqësues të OSHA-së.

Neni 18
Regjistrimi i hidrocentralit në ZRPP

Mbas vënies së hidrocentralit në punë, brenda 90 ditëve, OSHA-ja dhe Koncesionari hartojnë një akt dhe një situacion përmbledhës përfundimtar në të cilin përcaktohet se ndërtimi i hidrocentralit ka përfunduar sipas projektit dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje koncesionare. Ky dokument, së bashku me gjithë dokumentet e tjera që kanë shërbyer për realizimin e tij, dorëzohen pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rrethit Sarandë, e cila bën regjistrimin e hidrocentralit në emër të Koncesionarit.

Kur është e nevojshme dhe me miratim të Organit Shtetëror të Autorizuar, Koncesionari mund të hipotekojë si garanci pasuritë e shoqërisë, me kusht që pasuritë e hipotekuara të vazhdojnë të shfrytëzohen për të përmbushur objektivat e kontratës së koncesionit.

Neni 19
Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme

OSHA-ja ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari është i detyruar që çdo gjashtë muaj të raportojë me shkrim pranë OSHA-së, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas prodhimin e energjisë elektrike.

OSHA-ja ruan të drejtën që gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar se dispozitat e koncesionit do të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

OSHA-ja mund të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, ashtu si cilësia dhe konformiteti, të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Marrëveshjes, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim dhe do të vërë në zbatim masat e nevojshme për të ardhmen.

Neni 20
Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Për çdo gjë të paqartë, palët në kontratë do t'i referohen legjislacionit të shtetit shqiptar.

OSHA-ja garanton që çdo ligj i mëvonshëm që mund të interferojë me këtë Marrëveshje koncesioni, nuk do të ndryshojë në asnjë mënyrë detyrimet e marra përsipër nga palët sipas kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Neni 21
Forcat madhore dhe të parashikuara

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj Marrëveshjeje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve.

Gjatë zbatimit të kontratës, në rast se verifikohen vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të palëve, për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, ato nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe duke arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyerjes në kohë të punimeve do të përcaktohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes.

Neni 22
Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Koncesionit

Marrëveshja e koncesionit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastukturën publike".

Neni 23
Klauzola të përgjithshme

Kjo Marrëveshje është hartuar në 8 (tetë) kopje origjinale, 4 (katër) prej të cilave do të merren nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe 2 (dy) kopje do të merren nga Koncesionari.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet ndërmjet palëve që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje koncesioni, nuk do të anulojnë detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje, duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Marrëveshje koncesioni, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 25
Seksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizon palët sipas detyrimeve të marra prej tyre, me vendim të gjykatës së mësipërme.

Në rast vonesash në realizimin e projektit, të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 11, kur kanë kaluar më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë vonesë, Koncesionari detyrohet të paguajë OSHA-në për çdo vonesë penalitetin prej 0.01% të vlerës së investimit të parealizuar.

Neni 26
Bashkëpunimi ndërmjet OSHA dhe Koncesionarit

Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresën e mëposhtme:

ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR	KONCESIONARI
Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	"Wonder" Sh.a.,
Sheshi Skënderbej, nr.2, Tiranë	Rruga "Ismail Qemali"
Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	Qendra e Biznesit, kati i III-të
Sheshi Skënderbej, nr.2, Tiranë	Pallati përballë INIMA-s

ANEKSI NR.1
Hidrocentrali Sasaj Sarandë

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
I.	**Kanali i derivacionit**				
1	Germim dheu	m^3	3,000	300	900 000
2	Mbushje shtrese zhavorri	"	1,300	1,350	1,755,000
3	Beton M 150	"	500	13,500	6,750,000
4	Beton M 200	"	50	14,900	745,000
5	Hekur betoni	ton	5	76,000	380,000
II.	**Baseni me presion**				
1	Gërmime	m^3	22,000	300	6,600,000
2	Mbushje me dhe	"	1,500	180	270,000
3	Beton M. 150	"	3,000	13,500	40,500,000
4	Hekur betoni	ton	15	76,000	1,140,000
5	Mbushje me zhavorr shtesë	m^3	1,200	1,350	1,620,000
6	Konstruksione metalike	ton	5	135,000	675,000
7	Shtresë rruge e asfaltuar	m^2	800	2,550	2,040,000
III.	**Shkarkuesi anësor**				
1	Gërmim dheu	m^3	2,500	300	750,000
2	Shtresë zhavorri	"	50	1,350	675,000

3	Beton M.150	“	400	13,500	5,400,00
4	Hekur betoni	ton	2	76,000	152,000
IV.	**Dhoma e droselit**				
1	Beton M.150	m^3	50	13,500	675,000
2	Mur tulle	“	40	9,500	380,000
3	Mbulesë	m^2	35	2,500	87,000
V.	**Tubacioni i turbinës**				
1	Gërmim dheu	m^3	25,000	300	7,500,000
2	Gërmim shkëmbi	“	2,000	9,500	19,000,000
3	Beton M.150	“	1,800	13,500	24,300,000
4	Beton M 200	“	200	14,900	2,980,000
5	Hekur betoni	ton	10	76,000	760,000
6	Konstruksione metalike	“	20	135,000	2,700,000
7	Tubacion metalik 1100 mm	“	290	140,000	40,600,000
VI.	**Ndërtesa e centralit e n/st**				
1	Gërmim	m^3	9,100	300	2,820,000
2	Beton M 200	“	1,850	14,900	27,565,000
3	Vëllime ndërtese	“	4,800	8,500	40,800,000
VII.	**Kanali i largimit**				
1	Gërmime	m^3	600	300	180,000
2	Beton M.150	“	350	13,500	4,725,000
3	Hekur betoni	ton	20	76,000	1,520,000
4	Mur me gobiona	m^3	800	3,400	2,720,000
	Shuma (I-VII)	**lekë**			249,664,000
VIII.	**Linja 35 KW**	“			98,000,000
	Shuma (I-VIII)	“			357,664,000
	Montime 10%	“			35,766,000
	Shuma	“			393,430,000
	Shpenzime plotësuese 11%	“			43,277,000
	Shuma	“			436,707,000
	Ngritje kantieri 2%	“			8,734,000
	Shuma	“			445,441,000
	E adhura neto 15%	“			66,816,000
	Shuma	“			512,258,000
	fondi rezervë 7%	“			35,858,000
	Shuma	“			548,116,000
	TVSH 20%	“			109,623,000
	Shuma	**lekë**			657,739,000
a.	**Shuma (konv.U.S.D.)**	$			4,700,000

b.	Pajisje teknologjike hidroelektromekanike	$			4,200,000
	Shuma (a+b)	$			8,900,000
	Projekti	$			150,000
	Shpronësimet	$			400,000
	Shuma totale	$			9,450,000

VENDIM
Nr.508, datë 30.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për bashkëpunim në fushën e turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MOLDAVISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E TURIZMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë, më poshtë të quajtura "Palët",

nisur nga dëshira për të zgjeruar më tej marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy vendeve mbi baza të barazisë dhe përfitimit të përbashkët,

duke njohur rëndësinë e turizmit në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike dhe për një mirëkuptim më të madh ndërmjet popujve,

ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët do të ndihmojnë për zhvillimin, si dhe do të forcojnë bashkëpunimin në fushën e turizmit, do të rrisin shkëmbimet turistike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Moldavisë në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi në të dy vendet.

Neni 2

Palët do t'i kushtojnë rëndësi të veçantë zhvillimit të turizmit ndërmjet vendeve të tyre përkatëse nëpërmjet një turizmi të organizuar dhe individual, turizmit tematik, kongreseve, simpoziumeve, ekspozitave, festivaleve të teatrove, muzikore dhe aktiviteteve sportive.

Neni 3

Bashkëpunimi i përcaktuar në këtë Marrëveshje do të arrihet nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:

- krijimit të *jonit ventures* në fushën e turizmit;
- zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet kompanive turistike;
- shkëmbimit të ekspertëve, delegacioneve ose grupeve të ekspertëve në fushën e turizmit;
- organizimit të ekspozitave të përbashkëta, kongreseve, konferencave, simpoziumeve, tavolinave të rrumbullakëta;
- sigurimit të shërbimeve të konsulencës në fushën e shërbimeve hoteliere dhe restoranteve, për përgatitjen dhe për kualifikimin e personelit.

Neni 4

Palët do të mbështesin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, njësive, shoqërive turistike, si dhe organizatave të tjera të autorizuara për zhvillimin e turizmit në vendet e tyre respektive.

Neni 5

Palët do të nxisin institucionet e tyre publike dhe private për të shkëmbyer eksperiencën e tyre në fushën e turizmit dhe të statistikave në turizëm, si dhe në atë të publikimeve, shkëmbimin dhe shpërndarjen e materialeve turistike, materialeve promocionale, filma dhe reklama turistike me qëllim rritjen e fluksit të turistëve në vendet e tyre përkatëse.

Neni 6

Palët do të nxisin bashkëpunimin në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e personelit të turizmit, si dhe finalizimin e marrëveshjeve dhe vendosjen e kontakteve ndërmjet organizmave publikë dhe/ose privatë në lidhje me përpilimin e projekteve dhe studimeve turistike.

Neni 7

Palët do të përpiqen, nëpërmjet institucioneve të autorizuara, të zhvillojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me çështje të diskutuara nga Organizata Botërore e Turizmit.

Neni 8

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë:

- Në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizimit
- Në Republikën e Moldavisë: Drejtoria e Zhvillimit të Turizmit.

Neni 9

Palët do të përpiqen që në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendet e tyre përkatëse të thjeshtësojnë formalitetet e udhëtimit, si dhe procedurat e kontrollit kufitar me qëllim rritjen e fluksit turistik ndërmjet dy vendeve.

Neni 10

Palët do të zgjidhin mosmarrëveshje që mund të dalin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të cilat do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve dhe konsultimeve.

Neni 11

Palët, me mirëkuptim, mund ta ndryshojnë këtë Marrëveshje. Këto ndryshime do të përfshihen në protokolle të veçanta dhe do të jenë pjesë përbërëse të Marrëveshjes. Këto protokolle do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën palët do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme të parashikuara nga legjislacioni i secilës palë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një periudhë 5-vjeçare, e cila do të rinovohet automatikisht për një periudhë të njëjtë kohore nëse asnjëra palë nuk njofton palën tjetër në rrugë diplomatike për qëllimin e saj për të denoncuar Marrëveshjen të paktën 6 muaj përpara afatit të përfundimit të Marrëveshjes.

Bërë në Chisinau, më 11 qershor 2004, në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, moldave dhe angleze, të gjithë njësoj të vlefshëm.

Në rast mosmarrëveshjesh në lidhje me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM
Nr.509, datë 30.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PËRGJITHSHME TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË ARABISË SAUDITE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së përgjithshme të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Arabisë Saudite.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJA
E PËRGJITHSHME E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË ARABISË SAUDITE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Arabisë Saudite (këtej e tutje do të quhen "Palë Kontraktuese"),

duke dëshiruar të ngrejnë në nivele të larta marrëdhëniet ekzistuese të miqësisë midis dy vendeve, të forcojnë lidhjet historike midis kombeve të tyre,

të nxisin dhe të mbështesin bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve në fushat ekonomike, tregtare, investimeve arsimore, shkencore, teknike, kulturore, informimit, turizmit, rinisë dhe sporteve dhe

duke njohur përfitimet që mund të rrjedhin nga forcimi i këtij bashkëpunimi në përputhje me ligjet dhe legjislacionin ekzistues në të dy vendet,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe investimet ndërmjet dy shteteve dhe shtetasve, duke përfshirë personat fizikë ose juridikë. Ky bashkëpunim do të përfshijë, pa kufizime, si më poshtë:

1. Bashkëpunimin në të gjitha fushat ekonomike, veçanërisht projekte në industri, naftë, gaz, minerale, bujqësi, blegtori, turizëm dhe në mjekësi.

2. Shkëmbimin e njohurive teknike që kërkohen për programe specifike bashkëpunimi.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të nxisin përhapjen dhe shumëllojshmërinë e marrëdhënieve të tyre tregtare. Për këtë qëllim dhe brenda kufijve të sistemit tregtar ndërkombëtar dhe rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë, Palët do të aplikojnë regjimin e kombit më favorizues mbi shkëmbimet tregtare ndërmjet dy shteteve. Trajtimi i kombit më favorizues nuk do të përfshijë privilegjet e dhëna nga secila prej Palëve Kontraktuese shtetasve ose korporatave të vendeve të treta, si rezultat i vendosjes së një zone të lirë tregtare, një bashkimi doganor, një tregu të përbashkët, gjithashtu nuk do të përfshijë privilegje të dhëna vendeve më pak të zhvilluara ose çdo forme të bashkëpunimit ekonomik rajonal.

Neni 3

1. Palët Kontraktuese do të inkurajojnë dhe do të lehtësojnë investimet, në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi në të dy vendet, për shtetasit e tyre në të gjitha fushat, përveç atyre që janë të ndaluara nga legjislacioni i brendshëm.

2. Palët Kontraktuese do të garantojnë lirinë e transferimit të fondeve ndërmjet shteteve dhe mbrojtjen nga çdo veprim që ka si qëllim privimin e investitorëve nga pasuria e tyre ose një pjesë të kapitalit, ose të përfitimeve, duke përfshirë lirinë e transferimit të fondeve. Palët do të garantojnë një kompensim të drejtë dhe të shpejtë të investitorëve në rast të humbjeve të ardhura si rezultat i shkeljeve të këtyre dispozitave.

3. Palët Kontraktuese do të inkurajojnë krijimin e *joint-ventures* në përputhje me ligjin për investimet dhe legjislacionin ekzistues të të dy vendeve.

Neni 4

1. Palët Kontraktuese do të inkurajojnë shkëmbimin e vizitave ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe të delegacioneve ekonomike, tregtare dhe teknike duke përfshirë sektorët privatë dhe publikë.

2. Palët Kontraktuese do të inkurajojnë pjesëmarrjen në panaire tregtare që do të mbahen në dy vendet dhe do të sigurojnë të gjitha lehtësirat e nevojshme për to.

Neni 5

Palët Kontraktuese do të nxisin si më poshtë:

1. Inkurajimin e arsimimit, kërkimet shkencore, bashkëpunimin teknik dhe shkencor ndërmjet shkëmbimit të informacioneve të hapësirave me interesa reciproke, të shkëmbejnë informacione lidhur me kërkimet shkencore dhe teknologjinë, të shkëmbejnë vizita të përfaqësuesve zyrtarë dhe kërkuesve, ekspertëve dhe teknicienëve përmes trajnimeve kërkimore dhe asistencës teknike, duke marrë pjesë në simpoziume shkencore dhe konferenca me interesa reciproke.

2. Inkurajimin e bashkëpunimit kulturor rinor dhe sportiv përmes koordinimit të pozicioneve të tyre në forumet ndërkombëtare, shkëmbimin e programeve midis organizatave dhe bashkimeve sportive dhe rinore, gjithashtu shkëmbimin e vizitave dhe eksperiencave midis autoriteteve zyrtare për çështjet e rinisë dhe të sporteve.

3. Inkurajimin e bashkëpunimit në fushën e medias (radios, televizionit dhe shtypit) përmes shkëmbimit të vizitave dhe njohurive ndërmjet organizatave të mediave private dhe publike duke përdorur programe dhe teknologji, duke shkëmbyer materiale të medias dhe duke marrë pjesë në festat publike.

4. Inkurajimin dhe zhvillimin e turizmit ndërmjet dy vendeve, përmes shkëmbimeve të informacionit mbi turizmin dhe duke nxitur turizmin në grup dhe individual të shtetasve të tyre.

Neni 6

Palët Kontraktuese bien dakord të përdorin informacione të transmetuara reciprokisht vetëm për qëllimet e parashikuara dhe nuk mund t'i transmetojnë asnjë pjesë prej këtyre informacioneve një pale të tretë pa një marrëveshje të shkruar për këtë qëllim nga Pala Kontraktuese.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të nxisin përfundimin e marrëveshjeve të veçanta në fushat specifike me interes reciprok, kur është e nevojshme.

Neni 8

Palët Kontraktuese do të formojnë një komision të përbashkët që të ndjekë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kur është e nevojshme.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit reciprok përmes kanaleve diplomatike, duke konfirmuar plotësimin e procedurave të brendshme nga secila prej Palëve Kontraktuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të saj.

2. Kjo Marrëveshje do të përfundohet për një periudhë kohe prej 5 vjetësh nga hyrja në fuqi dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë vazhduese prej 1 viti, derisa njëra nga Palët Kontraktuese paraqet një njoftim të shkruar, të paktën 6 muaj para përfundimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim për ta denoncuar atë.

3. Në momentin e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të jenë efektive lidhur me ato programe, projekte dhe marrëveshje që janë përfunduar brenda kuadrit të tyre dhe kontratave ose detyrimeve që nuk janë përmbushur ose të drejtat që nuk janë zgjidhur, gjithashtu sqarimin e ndonjë detyrimi financiar akoma të pashlyer para përfundimit të kësaj Marrëveshjeje ose kur ato janë të gjitha të lidhura me qeverinë ose personat fizikë dhe juridikë.

Bërë në Tiranë, më 28 qershor 2994, në dy kopje origjinale, shqip, arabisht dhe anglisht, të gjitha tekstet do të jenë njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Zëvendësministri i Punëve të Jashtme Luan Hajdaraga	Për Qeverinë e Mbretërisë së Arabisë Saudite Zëvendësministri i Punëve të Jashtme Nizar O.Madani

VENDIM
Nr.511, datë 30.7.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.182, DATË 25.4.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 "Për barnat", të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.9135, datë 11.9.2003 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.182, datë 25.4.1995 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 4/1, 4/2 e 4/3 si më poshtë vijon:

"4.1 Barnat që hidhen në treg dhe qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, kanë të vendosur mbi kutinë e ambalazhit një pullë, për efekt kontrolli, si provë e regjistrimit të tyre, e marrjes së autorizimit për hedhjen e tyre në treg dhe për respektimin e çmimit përfundimtar të shitjes. Pulla e kontrollit i jepet subjektit fabrikues të barnave në Republikën e Shqipërisë ose subjektit shitës me shumicë të barnave nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, kundrejt pagesës, për çdo seri të barit të fabrikuar në vend ose të importuar.

a) Pulla e kontrollit përmban në mënyrë të detyrueshme këto të dhëna:

- emërtimin e barit;
- formë-dozën;
- serinë e prodhimit të barit;
- emrin e fabrikuesit/të importuesit të barit në Republikën e Shqipërisë;
- çmimin e shitjes me pakicë të barit;
- emërtimin e autoritetit që lëshon pullën: Qendra e Kombëtare e Kontrollit të Barnave.

Katër nënpikat e para të shkronjës "a" mund të shprehen në mënyrë të shifruar, me përjashtim të dy nënpikave të fundit, të cilat duhen shprehur me fjalë.

b) Pulla e kontrollit vendoset prej subjektit fabrikues të barnave dhe subjektit shitës me shumicë të barnave mbi kutinë ambalazhuese të barit. Ajo i referohet deklarimit të fabrikuesit ose shitësit me shumicë të barit dhe autorizimit për hedhjen në treg, për çdo seri të veçantë.

4/2. Hedhja në treg, shitja me shumicë dhe me pakicë e barnave nga subjektet pa pullën e kontrollit përbën shkelje të rregullave të fabrikimit e të tregtimit dhe ndëshkohet sipas neneve 53 e në vijim, të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 "Për barnat", të ndryshuar.

4/3. Barnat e hedhura në treg dhe që janë në qarkullimin brenda 90 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të pajisen me pullën e kontrollit.".

2. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.513, datë 30.7.2004

PËR KLASIFIKIMIN E VEPRIMTARISË DHE PËR DOKUMENTACIONIN E PROCEDURËN PËR DHËNIEN E LEJES NGA INSPEKTORI I PUNËS, PARA VËNIES NË PUNË TË NDËRMARRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 41 të ligjit nr.7961, datë 12.9.1996 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 139 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punëdhënësi, i cili në veprimtarinë e vet kryen punë të klasifikuara, të vështira ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, në përputhje me vendimin nr.207, datë 9.5.2002 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme", para vënies në punë të ndërmarrjes a të një pjese të saj, para hapjes së mjedisit të punës, si dhe para çdo ndryshimi të rëndësishëm në mënyrën e punës, për prodhimet e përdorura, makineritë dhe pajisjet, duhet të marrë leje nga inspektori i punës.

2. Punëdhënësi për marrjen e lejes paraqet pranë inspektoratit të punës së rajonit, në juridiksionin e të cilit ndodhet ndërmarrja, kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Planin, projektin e vendeve të punës për ajrimin, ndriçimin, zhurmat dhe dridhjet, ndotjen, substancat e rrezikshme;

b) Listën e lëndëve të rrezikshme, që do të përdorë në ndërmarrje;

c) Miratimin e planimetrisë së ndërmarrjes nga Inspektorati Elektrik;

ç) Sipërfaqen dhe vëllimin e vendit të punës;

d) Instalimin e makinerive dhe të pajisjeve.

3. Inspektori i punës verifikon dokumentacionin e paraqitur nga punëdhënësi dhe e njofton atë brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim, nëse ky dokumentacion është i rregullt apo ka nevojë për plotësime të mëtejshme.

4. Nëse dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës me shkrim, ka mangësi, punëdhënësi duhet ta plotësojë atë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.

5. Inspektori i punës, brenda 10 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi, verifikon vendet e punës në ndërmarrje për:

a) ajrimin dhe ventilimin, në përputhje me vëllimin, mjedisin dhe numrin e punonjësve;

b) daljet nga ndërtesa në rast zjarri;

c) masat mbrojtëse, kundër zjarrit;

ç) masat mbrojtëse kolektive dhe individuale;

d) garderobën dhe instalimet sanitare;

dh) ndihmën e shpejtë;

e) mjediset për ngrënie.

6. Inspektori i punës, brenda 5 ditëve nga përfundimi i verifikimit të vendeve të punës, vendos dhënien ose refuzimin e lejes.

7. Ankimi ndaj vendimit të inspektorit të punës për refuzimin e dhënies së lejes, mund të bëhet tek inspektori i përgjithshëm, i cili shprehet me vendim, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

8. Ankimi ndaj vendimit të inspektorit të përgjithshëm mund të bëhet te Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, i cili shprehet me vendim, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

9. Ankimi ndaj vendimit të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale mund të bëhet në gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

10. Ngarkohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.515, datë 30.7.2004

PËR LEJIMIN E INSTITUCIONEVE BUXHETORE TË PËRDORIN PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR BLERJE GAZOILI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e institucioneve buxhetore, që, për fondet limit të miratuara në buxhetin e vitit 2004, të paprokuruara, për të cilat nuk është shpallur fituesi deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përdorin procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë", me shoqërinë "ARMO" sh.a. Fier, për blerje gazoili, STASH 31:1997(D-2), të ndarë sipas loteve dhe çmimeve si më poshtë vijon:

- Gazoil STASH 31:1997 (D-2) për furnizimin e automjeteve me tolona, me çmimin 68 (gjashtëdhjetë e tetë) lekë/litër.
- Gazoil STASH 31:1997 (D-2) për furnizimin e automjeteve me autobote, me çmimin 64 (gjashtëdhjetë e katër) lekë/litër.

2. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.520, datë 30.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.771, DATË 13.11.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 82 pika 1 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 4, 5 dhe 24 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 28 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 1 të vendimit nr.771, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohen si më poshtë vijon:

"c. Institucionet buxhetore, duke filluar nga data 1 qershor 2005.

ç.Tatimpaguesit e regjistruar në mbështetje të ligjit nr.8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore për biznesin e vogël", të ndryshuar, duke filluar nga data 1 janar 2005.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.523, datë 30.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.243, DATË 26.3.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET BUXHETORE PËR VITIN 2004 DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.243, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen 1 "Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2004" të bëhen këto ndryshime:

a) Numri i punonjësve buxhetorë për Ministrinë e Shëndetësisë, për periudhën 1 maj-31 dhjetor 2004 ndryshon dhe bëhet "21 339".

b) Numri i punonjësve buxhetorë për Ministrinë e Mbrojtjes ndryshon dhe bëhet "8 911".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 maj 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.524, datë 30.7.2004

PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Oficeri aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që për shkak të detyrës emërohet larg vendbanimit të tij dhe kur nuk trajtohet nga Ministria e Mbrojtjes me banesë ose kredi në vendemërimin e ri, përfiton kompensim për qira banese deri në tre vjet, në masën dhe kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

a) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut për qira banese të tipit garsonier, kur nuk ka persona të tjerë në ngarkim;

b) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut për qira banese të tipit 1+1, kur ka në ngarkim deri në dy persona;

c) 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut për qira banese të tipit 2+1, kur ka në ngarkim më shumë se dy persona.

Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet, çdo vit, nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes, duke u bazuar në të dhënat e Institutit të Statistikës (INSTAT).

2. Oficerët, që përfitojnë kompensim për qira banese, duhet të paraqesin pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente:

a) Kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës;

b) Certifikatën personale;

c) Certifikatën familjare;

ç) Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes për emërimin në detyrë jashtë vendbanimit;

d) Kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar.

3. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist), i emëruar jashtë vendbanimit, i cili nuk e ka ndryshuar vendbanimin familjar, pasi nuk ka pasur mundësi strehimi, dhe nuk përfiton kompensim për qira banese, gëzon të drejtën e kompensimit në vlerë për ushqim, për tre vakte, sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të trajtimit me ushqim të efektivave, për ditët efektive të punës.

4. Ushtarakët e tjerë të shërbimit aktiv gëzojnë të drejtën e kompensimit në vlerë për ushqim vetëm për vaktin e drekës, sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të trajtimit me ushqim të efektivave, për ditët efektive të punës.

5. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet, çdo vit, nga Ministri i Mbrojtjes, në bazë të çmimeve mesatare vjetore, sipas buletinit të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Kur ushtaraku thirret në repart për nevoja shërbimi (gatishmëri, stërvitje, fushime) trajtohet me ushqim të gatuar sipas normës së repartit dhe nuk përfiton kompensim në vlerë.

7. Vendimi nr.505, datë 24.10.1994 i Këshillit të Ministrive "Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarakë aktivë, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë", i ndryshuar, nuk zbatohet për ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.525, datë 30.7.2004

PËR PROCEDURËN E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E LËNDËVE PLASËSE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të regjistrit shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili të hapet dhe të mbahet në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Çdo subjekt, që prodhon, eksporton dhe importon lëndë plasëse është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të aplikojë për regjistrimin e sasisë së këtyre lëndëve në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse.

3. Në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse regjistrohet edhe çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim, nga ana e prodhuesit dhe importuesit.

4. Subjektet që aplikojnë janë të detyruara të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a) Fotokopje të noterizuar të lejes së importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.

b) Adresën e saktë të personit juridik ose fizik (tel/fax, celular).

c) Proform-faturën nga uzina prodhuese, me llojin dhe sasitë e lëndëve plasëse, për subjektet importuese.

ç) Dokumentin vërtetues të llojit, sasisë së lëndëve plasëse, për subjektet që prodhojnë dhe eksportojnë.

d) Dokumentet teknike, që i përkasin tipit të miratuar.

dh) Një kopje të certifikatës ekzaminuese, EC.

5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Aneksi “A”

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

REGJISTRI SHTETËROR
I
REGJISTRIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Formati 390 x 265 cm

Aneksi “A”

Nr. Emërtimit (kodit) _____ njësia e matjes_____Çmimi _____

Nr	Data e regjistrimit	Dokumenti Vërtetues		Shkaku i veprimit	Lëvizje e brendshme	Sasitë e lëvizjeve			Sasitë sipas subjektet	
		Nr	Datë			Hyrje	Dalje	Mbetje		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

Nr. Emërtimit (kodit) _____ njësia e matjes_____Çmimi _____

Sasitë sipas subjekteve							Shuma totale	Shënime
12	13	14	15	16	17	18	19	20

VENDIM
Nr.526, datë 30.7.2004

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSPEKTORATIT TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimi e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet "Kryeinspektor", "Zëvendëskryeinspektor", "Përgjegjës sektori", "Inspektor" dhe "Specialist", në Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1- Diplomë e shkollës së lartë, është 9000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind për çdo vit pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Punonjësit e tjerë të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare të paguhen sipas lidhjes II-5 "Pagat bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore", miratuar me vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

7. Pagat e përcaktuara si më sipër të indeksohen sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr.74, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e indeksimit të pagave", dhe në masën e përcaktuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

8. Këshillit të Ministrave, në buxhetin e miratua për vitin 2004, t'i shtohet fondi prej 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, i cili të ndahet në zërat si më poshtë vijon:

- Zëri "Paga" 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë;
- Zëri "Sigurime shoqërore" 900 000 (nëntëqind mijë) lekë;
- Zëri "Investime" 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;
- Zëri "Mallra dhe shërbime" 1 000 000 (një milion) lekë.

9. Numri i punonjësve të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare për vitin 2004, të jetë 10 veta.

10. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4
	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Kryeinspektor	9 000	2%	0	90 000
Zëvendëskryeinspektor	9 000	2%	0	74 000
Përgjegjës sektori	9 000	2%	0	40 000
Inspektor	9 000	2%	0	30 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

VENDIM
Nr.531, datë 30.7.2004

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2004, PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË BURGJEVE TË PEQINIT DHE TË RROGOZHINËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të neneve 7, 8 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në numrin e miratuar të punonjësve për vitin 2004, t'i shtohen 88 veta.

2. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri "Shpenzime korente", t'i shtohet fondi prej 47 642 000 (dyzet e shtatë milionë gjashtëqind e dyzet e dy mijë) lekësh, për rritjen e kapaciteteve të burgjeve të Peqinit dhe të Rrogozhinës, i ndarë si më poshtë vijon:

- Paga 24 040 000 lekë;
- Sigurime shoqërore 7 395 000 lekë;
- Shpenzime operative 16 207 000 lekë;

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

AUTORIZIM ZYRTAR
Nr.8, datë 19.7.2004

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" (i ndryshuar) dhe pikave 4 dhe 4.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.229, datë 28.4.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve" Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

AUTORIZON:

Shoqërinë "Sicred" sh.a., me seli në Tiranë, të ushtrojë veprimtari sigurimi për jetën, në përputhje me lejen për ushtrim veprimtarie.

KRYETARI
Gëzim Agasi

AUTORIZIM ZYRTAR
Nr.9, datë 19.7.2004

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" (i ndryshuar) dhe pikave 4 dhe 4.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.229, datë 28.4.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve" Komisioni i Mbikëyrjes së Sigurimeve

AUTORIZON:

Shoqërinë "Inter Albanian" sh.a., me seli në Tiranë, të ushtrojë veprimtari sigurimi për jo-jetën (dëmet), në përputhje me lejen për ushtrim veprimtarie.

KRYETARI
Gëzim Agasi

AUTORIZIM ZYRTAR
Nr.10, datë 19.7.2004

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" (i ndryshuar) dhe pikave 4 dhe 4.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.229, datë 28.4.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve" Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

AUTORIZON:

Shoqërinë "Albsig" sh.a., me seli në Tiranë, të ushtrojë veprimtari sigurimi për jo-jetën (dëmet), në përputhje me lejen për ushtrim veprimtarie.

KRYETARI
Gëzim Agasi

AUTORIZIM ZYRTAR
Nr.11, datë 28.7.2004

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" (i ndryshuar) dhe pikave 4 dhe 4.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.229, datë 28.4.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve" Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

AUTORIZON:

Shoqërinë "Sigal life" sh.a., me seli në Tiranë, të ushtrojë veprimtari sigurimi për jetën, në përputhje me lejen për ushtrim veprimtarie.

KRYETARI
Gëzim Agasi

Ndreqje gabimi

Në vendimin nr.296, datë 14.5.2004 të Këshillit të Ministrave "Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të komitetit të sigurisë së aviacionit civil të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza"", botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, datë 21.5.2004, në pikën 12 të tij, numri 427, bëhet 727, numër ky i cili i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave që shfuqizohet.

Fletorja Zyrtare gjendet:
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE 1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË 400

Doli nga shtypi më 18.8.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë